

TË GJETURAT KRYESORE

Kontratat “marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV)” apo siç njihen ndryshe si kontratat mbi vepër janë pak të mbuluara në raporte të institucioneve publike dhe po ashtu pak të hulumtuara deri tani nga organizata të shoqërisë civile në Kosovë;

Në vitin 2016 janë lidhur 1,372 kontrata, derisa në vitin 2017 rreth 2,906 kontrata mbi vepër në nivel qendror dhe lokal. Ministrinë me numrin më të madh të këtyre kontratave në këto dy vite janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Infrastrukturës (MI) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);

Sa i përket vitit 2018, në bazë të përgjigjeve të 76 institucioneve (nga 132 kërkesa të dërguara) numri i kontratave mbi vepër ka qenë 777. Ky numër do të ishte dukshëm më i lartë nëse do të përfshinin edhe 56 institucionet tjera të cilat nuk janë përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare;

Sa i përket komunave për vitet 2016 dhe 2017, numrin më të madh të kontratave mbi vepër e kanë: Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Peja, Prizreni, Suhareka, Fushë Kosova dhe Gjakova; Në vitin 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka angazhuar rreth 958 persona me kontrata mbi vepër në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Megjithatë, edhe nëse e heqim këtë numër, dallimi në numër të kontratave në mes të 2016 dhe 2017 është rritur për 576 raste apo 42%;

Nëse marrim për bazë që të punësuar janë rreth 18,000 nëpunës civilë në nivel qendror dhe lokal dhe i shtojmë numrin prej 1,948 rasteve në vitin 2017 (pa llogaritur 958 të KQZ-së), del që 10% e totalit të të punësuarve në shërbimin civil në vitin 2017 kanë qenë me kontrata mbi vepër; Në vitin 2016 dhe 2017 më shumë ka pasur rekrutime me kontrata mbi vepër (861 dhe 991) se sa rekrutime të rregullta (645 dhe 723). Pastaj, një numër i konsiderueshëm i tyre janë lidhur pa procedura të thjeshtëzuara të rekrutimit dhe me kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj;

Në vitin 2016 dhe 2017 ka pasur raste kur të angazhuarve madje u janë lëshuar akt-emërime me afat të pacaktuar dhe janë futur në listën e pagave në kundërshtim me rregullat e përcaktuara me Ligjin për shërbimin civil;

Sa i përket respektimit të afatit ligjor prej gjashtë muajve për këto kontrata, sipas përgjigjeve me shkrim nga 76 institucione për vitin 2018, një numër prej 164 rasteve nga 777 të deklaruara gjithsej kanë qenë jashtë afatit ligjor (në të cilën shifër 84 janë të nivelit lokal dhe 80 të nivelit qendror).